



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.1729/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari individual Dren Rogova, në çështjen përmbartimore të kreditorit Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza nr.34/3, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A., me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për kthim në gjendjen e mëparshme dhe ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar propozimi i kreditorit, për kthimin në gjendje të mëparshme në këtë çështje juridike, LEJOHET kthimi në gjendje të mëparshme i procedurës për shqyrtimin e ankesës ndaj aktvendimit, ashtu që anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë Kom.Dh.Shk.II.nr.964/2023 i datës 16.10.2023 dhe.
- II. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza, Nr.34/3, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.281/2022 i datës 16.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, ka aprovuar si të bazuar propësimin e debitorit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A., ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.530/2020 të datës 09.09.2020 të përmbartuesit privat Valdrin Beka dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër aktvendimit të lartcekur ankesë ka ushtruar kreditori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që propësimi të refuzohet si i pabazuar ndërsa urdhri për përmbartim P.nr.530/2020 i datës 09.09.2020 të mbetet në fuqi.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar ankesën e kreditorit, me propozim që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.281/2022 i datës 16.02.2023 të vërtetohet.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr.964/2023 të datës 16.10.2023 ka hedhur poshtë si të pas afatshëm ankesën e kreditorit Shoqata e

Sigurimeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza, Nr.34/3, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.281/2022 i datës 16.02.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Propozimi i kreditorit për kthim në gjendjen e mëparshme është i bazuar.

Ankesa e kreditorit e paraqitur kundër aktvendimit KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza, Nr.34/3, me datë 08.09.2020 ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave si në propozim për përmbarim, për shumën e detyrimit prej 49,501.80 Euro.

Përmbaruesi privat Valdrin Beka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.530/2020 të datës 09.09.2020, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbarim. Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim me datë 22.09.2020, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin, me arsyetimin se propozimi për përmbarim nuk i përmban të gjitha elementet e nevojshme në mënyrë që ai propozim të jetë i qartë, të jetë në pajtim me dokumentin në bazë të cilit propozohet. Po ashtu faturat nuk janë të nënshkruara nga debitori siç edhe kërkohet me çka është vërtetuar se Kompania e Sigurimeve Dukagjini, SH.A., nuk ka pranuar kurrfarë shërbimi sipas faturave të lëshuara nga ana e kreditorit. Ka shtuar se faturat të cilat kanë qenë të pranuar nga ana e debitorit dhe të cilat janë paguar kanë qenë faturat mbi trajnimet e vazhdueshme dhe trajnimet mbi licencim dhe ato fatura janë të paguara ndërsa, për faturat kontestuese nuk ka marrë asnjë shërbim. Andaj, ka propozuar që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri i caktuar sipas propozimit të kreditorit P.nr 530/20 i datës 09.09.2020, si dhe propozimi për përmbarim të refuzohet si i pa bazuar. Përgjigje në prapësim nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A., ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.530/2020 të datës 09.09.2020 të përmbaruesit privat Valdrin Beka dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, për arsye se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e

kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk kanë dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke e shqyrtuar ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimi KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, ka gjetur se e njëjta nuk paraqitur brenda afatit ligjorë, andaj me aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr.964/2023 të datës 16.10.2023 ka hedhur poshtë si të pasafatshëm ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.281/2022 i datës 16.02.2023.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së kreditorit për kthimin në gjendje të mëparshme, ka vlerësuar rrethanat e pretenduara nga kreditori dhe ka aprovuar propozimin si të bazuar. Kjo për faktin se gjykata ka gjetur se kreditorit brenda afatit ligjor e ka dorëzuar ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, e kjo vërtetohet në bazë të dërgesës së parashtresave të postës së datës 04.04.2023 dhe 05.04.2023, çka nënkupton se ankesa e kreditorit është paraqitur në kohë, por ka qenë lëshimi i zyrës postare që parashtresa nuk është procesuar me kohë. Andaj, gjykata duke pasur parasysh faktin se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 129 i LPK-së, ka aprovuar kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme të kreditorit si të bazuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes me aktvendimin KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se faturat e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*, kurse me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumta dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokumente të besueshëm mbi të cilat është iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë

e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit KPPP.nr.281/2022 të datës 16.02.2023, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 129 dhe 209 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.1729/2023 me datë 12.03.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova